

BESIMTARI

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkodër
Viti II i botimit, Qershor 2008 Nr. 14. Çmimi 20 lekë.
www.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it

Kryeredaktor Selim Gokaj



QEVERIA E TURQISE KERKON RISHKIMIN E MARRDHËNIEVE HISTORIKE ME SHQIPTARET

Sapo ka përfunduar një vizitë në Turqinë mike të popullit shqiptar dhe në veçanti e Kosovës, ministri i arsimit i qeverisë së Kosovës së Pavarur, z. Enver Hoxhaj i cili u prit me nderime të veçanta nga zyrtarë të lartë të qeverisë turke që ishin përfaqësues të një shteti që e mbështeti pa rezerva Kosovën në rrugën drejt Pavarësisë dhe ishte pikërisht shteti turk që e njohu i pari Kosovën e Pavarur.

Por, ministri kosovar, Hoxhaj, u gjend papritur përballë një kërkesë tashmë të njohur të qeverisë turke e cila kërkon të rishikojë historinë e marrdhënjeve të shqiptarve me Perëndorinë Osmane nën dritën e së vërtetës, sepse shqiptarët, përmes asaj që mësojnë në tekstet e historisë në shkolla dhe në hapësira të tjera arsimore – studimore, kanë krijuar një ide jo të saktë për këto marrdhënje . Arsyja ka qenë se populli shqiptar, në të dy anët e kufirit të tij, ka rënë pre e një historie që ka pasë frymë të theksuas sllavo-ortodokse e cila i ka paragjykuar këto marrdhënje duke e penalizuar Perëndorinë Osmane si shkaktare e prapambetjes së shqiptarve gjatë shekujve të fundit .Ministrit të Arsimit të Kosovës iu kërkua që tekstet shkollore në Kosove të rishikohen ,sepse nxënësve kosovarë u mësohet se populli turk ka qenë popull pushtues gjë, sipas pales turke, nuk është e vërtetë. Qeveria turke i përcolli ministrit kosovar mesazhin sipas të cilit, qeveria turke nuk është dakort me përmbajtjen e teksteve të historisë që trajtojnë marrdhënjet e shqiptarve me Perëndorinë Osmane.Për qeverinë turke, Perëndoria Osmane nuk ka qenë pushtuese, por ajo ka investuar fuqishëm në rajonin e Ballkanit, duke lënë të nënkuptohet se për fatin e Ballkanit nuk mund të vendose askush jashtë interesave të



Turqisë.

Qeveria turke i kujtoi ministrit Hoxhaj se e vërteta e historisë së marrdhënjeve të Perëndorisë Osmane me shqiptarët është në arkivat turke nga ku edhe duhen bërë studimet nga historianët dhe të tjerë që janë të interesuar për zbardhjen me vërtetësi të këtyre marrdhënjeve. Duket se Turqinë e shqetëson vazhdimisht çështja në fjalë, sepse në takimet dhe axhentat e politikanëve shqiptarë të të gjitha rangjeve me politikanët turq korespondues ,këta të fundit u kanë përcjellë kolegje të tyre shqiptarë shqetësimin e Turqisë për shtrembërimin e historisë së marrdhënjeve të shqiptarve me Perëndorinë Osmane, .kujtojmë vizitën e fundit të kryeministrit turk, Taip Rexhep Erdogan , cili i kërkoi qeverisë shqiptare që të rishikojë këto marrdhënje dhe në veçanti historinë që u mësohet shqiptarve për figurën e Skenderbeut ,e cila nuk është e vërtetë në atë linjë që e mësojnë shqiptarët sot. Duke i bërë jehonë trysnisë së qeverisë turke për t,u mësuar të vërtetën për historikun e këtyre marrdhënjeve ,ish-

drejtori i arkivave shqiptare , Shaban Sinani, bëri një deklaratë mediatike, ku theksoi se nuk është e vërtetë që shqiptarët kanë luftuar gjithmonë me turqit, por ka pasë periudha të gjata qetësie, kur ata kanë jetuar pranë njëritjetrit dhe kanë bashkëqeverisur fatin e Shqipërisë në vitet , kur shqiptarët kanë jetuar në Perëndorinë Osmane. Mendojmë se flamurin, në mënjanimin e miqësisë dhe të lidhjeve të fuqishme të shqiptarve me Perëndorinë Osmane ,e mbajnë mediat shqiptare që vuajnë nga një turkofobi e theksuar e cila lidhet me botuesit e tyre dhe financuesit e tyre që duket se janë në një linjë politike me ato të cilët duan ta largojnë Shqipërinë nga miqtë e vërtetë dhe ta lidhin pas qerres së atyre që historikisht kanë qenë në opozitë me përpjekjet e shqiptarve për të shikuar përpara dhe për të ecë përpara. Ne një cikël shkrimesh të botuara në gazetën "Republika" për këtë tematikë, në muajin janar 2008 ,ish-diplomati shqiptar dhe analisti i njohur, Abdi Baleta ,do të jape një divizë të cilën duhet ta kenë të qartë të gjithë ata që

studjojnë historinë e Shqipërisë dhe janë të interesuar për ta paraqitë atë sa më saktë .Sipas Abdi Baletës ,Antiturqizmi është Antishqiptarizëm.Me datën 26 mars 2008, në Shqipëri bëri një vizitë kryeministri i Turqisë, z.Taip Rexhep Erdogan që shoqërohej edhe nga ministri i arsimit i cili nënshkroi një marrveshje me homologun e tij, Pollo ku parashikohet që të rishikohen marrdhënjet e shqiptarve me Perëndorinë Osmane, sepse këtu bëhet fjalë, jo për të ulur tensionet në Ballkan midis popujve sipas udhëzimeve tëBE,por për të korigjuar gabimet që i janë bërë trajtimit të Perëndorisë Osmane nga historiografia shqiptare që ishte e manipuluar nga qarqe sllave dhe ortodokse të cilët kishin instaluar në Shqipëri historiane që nuk kishin identitet shqiptar dhe që për fatin e keq të shqiptarve shkruanin historinë e Shqipërisë Le të shpresojmë që politika shqiptare ta mare serjozisht mesazhin që solli kryeministri i Turqisë dhe të reflektojë, duke u distancuar nga ruminishencat e turkofobisë të cilave nuk u ka shpëtuar, as politika shqiptare, që përfaqëson magjorancën parlamentare dhe as politika e opozitës parlamentare,sepse po vazhdoi t,i serviret brezit të ri një histori që është e montuar mbi jo të vërteta, prapa të cilave qëndron një prapavijë politike antishqiptare, atëherë brezi i ri, që do të vijë pas, t'i akuzojë me të drejtë historianët e sotëm se ato me fatin e Shqipërisë i paten lidhur disa fije të holla peri, kurse me armiqtë e Shqipërisë i paten lidhur zingjirë të hekurt ,falë të cilëve këta historianë po përpiqen të lënë pas për shqiptarët një histori të helmuar dhe jo të vërtetë

Selim Gokaj
Shkodër ,me24 mars 2008

Sureja Jasinë
XHABIR HAMITI

PROBLEMET E LIGJERIMIT ISLAM...
JUSTINIAN (ISMAIL) TOPULLI

fq. 2

fq. 3

TE ALLAHUT JEMI DHE TEK AI DO TE KTHEHEMI

Studentet muslimane te Universiteteve te Turqise
do te mbajn shami

fq. 5

fq. 6

Ortaket e djallit
BURHAN FILI

THIRRJE E HAPUR PER GENOCID KUNDER MUSLIMANEVE NE SHQIPERI

SELIM GOKAJ

fq. 6

fq. 7

Sureja Jasinë

Xhabir Hamiti

Interesimi i shqiptarve për t'u njohur me fjalën e shenjtë të Kur-anit ka qenë i hershëm dhe dorëshkrimet e autorve shqiptarë për këtë tematikë në gjuhën turke dhe arabe ruhen edhe sot në arkivat e ndryshme lokale dhe kombëtare. Librat e pare në gjuhën shqipe mb i përkthimin e Kur-anit datojnë mja mesi i viteve 20 të shekullit të xx dhe ky interesim iu rrit pas shpalljes së Pavarësisë në vitin 1912. Shefqet Muka nuk njihet në mesin e shqiptarve vetëm për përkthimin e sures së Jasinës por ai është i njohur si një pedagog me peshë në Shkodër dhe në të gjithë Shqipërinë. Nxënësit e medrezesë së Shkodrës duke pare shkallën intelektuale të Shkodranit (pseudonimi) i Shefqet Mukës, kërkuan që ai të merrej me përkthimin e sures së Jasinës për të cilën ai dëshmon në parathënien e Jasinës "Sot falmnderit mujta me e ëue në vend dëshirën tuejqi patët për me përkth në gjuhën aq të ambël tonën Suren e Jasinës. Muka e dinte se gjuha e Kur-anit nuk mund të përkthehej lehtëdhe pohon se "Se një penz e ligsht si kjo e jemja s' ish e dej me ba një përkthim të tillë, por vullnet që kena me mkambë atë që mungon më trimëroi e më shtyni me ba atë që asht e mundunme dale prej meje. Më duhet të theksoi se të parët fesë islame ndër shqiptarët ishin ferae dhe atdhetarë sepse ata kultivonin tek besimtarët ndjenjat feare islame dhe patriotizmin dhe atdhedashurinë. Dhe se pasi po konsilidohej shteti shqiptar ata ishin shumë të gëzuar "Me botime librash e përkthime në gjuhen ytonë të dashur ka me pasë rastin zogu i shqiptarit musliman me mësue e me njoftë fenë e vet.

Muka kishte diapozon të gjërë përkulturën fetare dhe ate të përgjithshme. Në kohën kur ai jetoi muslimanët shiheshin me sy të keq dhe ndaj tyre bëhej një propogandë tendencioze duke e brengosur shumë Shkodranin "Sot në botën e kulturave muslimani kqyret me sy të lig dhe akuzohet pa të drejtë edhe pse feja e tij nuk ka asnjë të metë .Pë ne muslimanët është detyrë fetare kolektive që ta shlyejmë këtë sykeqësi dhe t'i dëftojmë botës së qytetnume se ndër ne vlon shpirti cultural dhe lirishtës."Këto fjalë sot konçidojnë me gjendjen aktuale të muslimanëve. Pas 11 shtatorit dhe ngjarjeve të ngjashme me atë ndaj muslimanëve po bëhet nj propogandë që i paraqet si: degadentë , të egër, vrashtar etj.

Shkodrani kujton se bazat e qytetërimit janë të mbështetura tek intelektualët muslimanë që sunduan në



NË MES SHEFQET MUKA

Spanjë. "Spanja qe gurra e dijes dhe e shkencës e përparimit dhe e qytetnimitdhe se fyerja që i bani muslimanëve është e padrejtë dhe e adresuar gabimisht" Vlera e Jasinës.

Përkthyesi ishte i njohur dhe i informuar për rendësinë e sures Jasinë dhe u bën të njohur lexuesve: "Zotnija e jonë Pejgameri ka urdhnuar e ka thane se Jasina ashtë zemra e Kur-anit dhe se ajo i mban gjallë zemrat e muslimanëve duke mos i lane që të bien në errësinën e zezë të mosbesimit dhe se ka vetëm një Zot të Vetëm të gjithpushtetshëm.

Shkodrani i kujton lexuesit se është mbështetur në përkthimin e Kur-anit Kerim të profesor Smajl Hakiut dhe të Mevaqibit. Parathanja e përkthyesit është një analizë rreth përmbajtjes së kaptinës dhe rendësisë së saj dhe e detyrave të besimtarve muslimanë ndaj saj. Vështrim i përgjithshëm mbi përkthimin e Jasinës

Phurjes së shkurtër Shkodrani fillon me përkthimin e Jasinës ku vendos arabisht dhe shqip Bismilahun dhe "Me emnin e Zotit mbrojtës, falës" Autori vazhdon duke dhënë të dhëna për suren Jasini: numuri

i ajeteve, vendi i zbritjes dhe domethënia e fjalës.

Përkthimi ka shumë vlerë sepse aty jepen komente shtesë për të kuptuar më mire ndonjë ajet . Këto shenime për t'u dalluar nga teksti i Kur=anit janë të nënvizuara dhe ai është munduar që të përshtasë tekstin arabisht me gjuhen shqipe. Shkodrani ka synuar që kuptimi i Jasinës të jetë sa më i qartë për lexuesin. Shkodrani nuk i ik tekstit koranor , por përdor edhe fjalë për të dhënë një kuptim sa më të qartë duke vazhduar kështu rrugën e literatureës islame që ka bërë shpjegime dhe komente për ajetet e Kur-anit

Për ilustrim po japim disa citate kuranore për t'i krahasuar me përkthimet bashkohore

Ajeti 5 Kur-ani është zbritje etë Plotfuqishmit.

Kur-ani është shpallje e të Plotfuqishmit, Mëshiruesit

Ajeti 19 Ata (të dërguarit) thane: 'Fati keq është juaji, apse u këshilluat, a(na kërcënoni)?

Jo por ju jeni popull i shfrenuar!.

23

Përkthimet e Shkodranit për këto

dy ajete: a.Kur-ani është një libër zhdryp prej të Lumit që është i vetmi ngadhnyes e fjalës,Pejgamerët prej ktyne fjalëve su tundzuen aspak ,por ju thane përsëri:" Nga shkaku i qufrit e keqja asht ndër ju.Këshillat që ju dhanë , vërejtjet që u janë ba, apër të keq do t'i merrni? Ju jeninjë komb që e keni lane rrugën.Gjuha që përdor Shkodrani për këtë përkthim është gjuha e gegërishtes.

Duke krahasuar përkthimet e viteve 80 me atë të Shkodranit për Jasinën del se ai i Shkodranit është ma afër origjinalit kuranor, por që duhet të përshtatet pa tjetër me gjuhën e sotme letrare.Unë besoj se me punimet e tjera të Shkodranit në të ardhmen do të mren stujues të ndryshëm të cilët do të zbardhin vlerat e tyre kur dime se në arkivin e familjes ruhen shumë dorëshkrime të vlefshme, për të cilat më informoi djali i tij Adnan

Mukakur vizitova shtëpinë e tij i cili më dhuroi përkthimin e Jasinës dhe të dy ilmihalëve të përgaditura nga Shkodrani për shkollat fillore të asaj kohe.Duhet tëpunohet që të zbardhet figura e Shefqet Mukës se është detyrim fetar dhe kombëtare ai ishte edhe nacionalist i vendosur i çështjes kombëtare dhe kundërshtar i vendosur i komunizmit që e pat dënuar me vdekje duke e kthyer pastaj me burgim tëpërpjetshëm. Por ai ishte edhe fetar i madh dhe mësues i fesë islame. Është dekoruar me titullin "Mësues i Popullit"

Nga ish- presidenti Sali Berisha për ndihmesën e tij në arsimin shtetëror.Përkthimi i Jasinës nga Shkodrani tregon sevlera e fjalës së shkruar nuk vdes dhe se betimi i Allahut xh.sh. në pendë-laps ka ardhë për muslimanët me qëllim dhe me domethënie të thellë, sepse lapsi me të cilin shkruan njeriu ka peshë më shumë seazgjë tjetër. Unë po ju kujtoi se nxerrja në dritë dhe studimi i veprave të intelektualit fetar dhe patriotic Shefqet Muka është privilegj dhe çuarje në vend e betimit të zotit për pendën në Kur'anin e Madhnueshëm.

Kumtesë e mbajtur në Prishtinë në simpoziumin "Kur'ani dhe shqiptarët."

Probleme të ligjërimit islam në mesin e muslimanëve shqiptarë

Justinian (Ismail) Topuli - teolog

Ky shkrim, nuk synon të evidentoj ndonjë problem të pa trajtuar më parë dhe të pa vënë re në historinë e këtyre shtatëmbëdhjetë viteve të rilindjes së fesë në mesin e shqiptarëve dhe në veçanti në mesin e shqiptarëve të Shqipërisë. Ky shkrim synon të bëjë një analizë të pjesshme dhe njëkohësisht një reflektim realist e fetar të një nga problemeve më madhore me të cilat përballet sot thirrja islame në mesin e shqiptarëve. Më së shumti rrok ata që me të mirat dhe këqijat e tyre, sukseset dhe gabimet e tyre mbajnë barrën më të madhe në këtë drejtim. Me këtë shkrim në radhë të parë u drejtohem të gjithë vëllezërve dhe kolegëve të mi hoxhallarë, thirrës dhe predikues të Islamit, duke mos përjashtuar këtu nga vërejtjet as veten.

Me ndarjen nga kalifati osman muslimanëve shqiptarë iu desh të përballeshin me një realitet të ri. Ata që dikur kishin qenë në kufijtë e botës islame tani gjendeshin si një ishull në mes të botës së kufrit, në një realitet të tillë lindte nevoja e një strukturimi të ri, përgjigje të ndryshme pati në këtë drejtim, madje edhe me kahe të kundërta. Vitet që vijuan nuk mundën të konsolidonin një strukturim të qartë, i cili do të jetonte dhe do të merrte jetë. Në një periudhë kohe të shkurtër ishulli shqiptar i islamit u lag deri në themel nga detet e kufrit dhe ardhja e regjimit komunist në pushtet do të vuloste tashmë shndërrimin e tokave shqiptare në një vend të Darul-kufrit.

Ndërrimi i regjimeve i gjeti muslimanët shqiptarë jetim, që tashmë të dal nga "përkujdesja" e njerëz parti u vunë në kërkim të identitetit të tyre të humbur. Si jetim që ishim, dhe jemi, ne nuk morëm një edukim dhe përkujdesje të mirëfilltë fetare prindërore, ndaj dhe dashur padashur si ai jetimi që endet rrugë më rrugë e shtëpi më shtëpi edhe ne u endëm në kurse mbas kursi dhe vende pas vendesh për të njohur të vërtetën e fesë që mbarte origjina jonë.

Feja është jetë dhe jeta nuk mësohet vetëm në bankat e shkollës, madje ajo më pak se kudo tjetër mësohet aty, por mungesa e theksuar e edukatorëve prindëror dhe e hoxhallarëve që krahas dijës do të kishin edhe përvojën e jetës, rezultoi në disa aspekte, negative për brezin e ri të teologëve në përgjithësi dhe thirrjes islame në veçanti. Është e natyrshme që për këtë arsye dhe të tjera edukimi ynë fetar të rezultonte me mangësi të ndryshme, pasojat negative të cilave vazhdojnë të na ndjekin akoma nga pas, nganjëherë edhe si jehonë e mëkateve të shkuara, të cilat nuk lënë rast pa na i kujtuar.

Ftesa e njerëzve për t'iu kthyer besimit bëhet nëpërmjet thirrjes, nëpërmjet ligjërimit fetar, i shkruar apo i folur qoftë ky. Ky ligjërimit ka nevojë të ripërtërihet e të përshtatet si në përmbajtje

ashtu edhe në formë. Ai nuk duhet të humbasë kursesi thelbin e kësaj feje, njësimin e Zotit, por nga ana tjetër duhet të bëhet më i prekshëm dhe i gjallë nga ambienti në të cilin ne jetojmë. Me ripërtëritje të ligjërimit islam nuk dua tu bëj jehonë tendencave që kërkojnë të tronditin themelet e vetë fesë, por të tërheq vëmendjen që ligjërimit islam të përshtatet sa më mirë me realitetin ku jetojmë. Kjo gjë para se të jetë një kërkesë e nevojës së thirrjes islame është një detyrim fetar që ne praktikisht dhe deri diku edhe teorikisht pak e kemi njohur.

Allahu i Lartësuar duke folur për thirrjen e Profetëve thotë: *"Ne nuk kemi çuar asnjë të dërguar, përveçse në gjuhën e popullit të tij, për t'u shpjeguar atyre (shpalljet e Zotit). Allahu e shpie në humbje kë të dojë dhe e udhëzon në rrugë të drejtë kë të dojë. Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti."*¹

Me gjuhë këtu duhen kuptuar dy anë, gjuha me të cilën një popull flet dhe komunikon dhe gjuha e temperamentit, zakoneve dhe shprehive të tij të përditshme me të cilat ai jeton. Që të dyja këto anë i përmban ajeti i mësipërm. Nëse gjuha e folur ka të bëjë me të kuptuarin e drejtpërdrejtë, shpjegimi ka të bëjë me ndjesinë që duhet të përjetohet zemra për të reflektuar karshi asaj që dëgjon.² Për të parën dëshmon historia e Profetëve, e origjinës, e popujve dhe e gjuhës që ata flisnin. Vetë Zoti foli në këto gjuhë dhe librat e këtyre Profetëve u shkruan prej fjalëve të Tij, ashtu siç dimë që Ai foli në arabisht me mesazhin e Tij të fundit, Kur'anin. Ndaj është më se e natyrshme që domosdoshmëria e përcjelljes së Islamit të bëhet nëpërmjet gjuhës që çdo popull flet dhe kupton. Për këtë, dijetari islam Ibn Tejmije shprehet se ekziston një unanimitet në mesin e dijetarëve islam që lejon përkthimin e kuptimeve të Kur'anit në gjuhë të tjera për ata që nuk e kuptojnë arabishten. Madje ai përmend se ka edhe një pakicë dijetarësh të cilët e lejojnë që gjatë faljes të këndohet surja fatiha e përkthyer, për ata që nuk mundën ta mësojnë atë në arabisht.³

Duke u nisur nga ky fakt i rëndësishëm duhet thënë se ligjërimit islam në mesin e shqiptarëve sot, shpeshherë karakterizohet nga një mbingarkesë e panevojshme e termave dhe e fjalëve në gjuhën arabe apo nganjëherë edhe në ato turke të trashëguara. Disa prej këtyre fjalëve kanë qenë të kuptueshme për brezat e dikurshëm, por sot ato janë kthyer në fjalë të padëshifrueshme për shumicën e njerëzve. Ky realitet krijon një barrierë ndërmjet njerëzve dhe përcimit të mesazhit që këto fjalë mbartin. Këtu nuk duhet të harrojmë se njerëzit që vinë në xhami vetëm për xhuma dhe për bajram nuk janë të familjarizuar me këto fjalë ashtu sikurse

1. Ibrahim: 4.
2. Mexhmu el-fetaua 9/64.
3. "Përgjigja e saktë (e Ibn Tejmijes) për atë që ndryshoi fenë e Mesisë" 2/55, 56, 67. (në arabisht)

ata që marrin pjesë rregullisht në mësimet dhe në faljet ditore, për të mos folur këtu për publikun që qëndron jashtë xhamive apo ata që vijnë për herë të parë në të. Këtu duhet përmendur edhe sikleti e më pas indiferenca që njerëzve u shkakton mësimja e shumë fjalëve të huaja e të pakuptueshme, që kryesisht e kanë origjinën nga gjuhët perëndimore dhe jo më tu flasësh atyre me fjalë arabe dhe turke.

Një tjetër problem që vihet re në ligjërimit islam, sidomos në përkthimin, është edhe arabizimi i strukturës së shqipes, e thënë ndryshe të folurit dhe kryesisht të shkruarit arabisht me fjalë shqipe. Si arabishtja ashtu edhe shqipja kanë rregullat e tyre gramatikore, të cilat duhen respektuar në raste përkthimesh, ndaj është tejet e gabuar që gjithkush që mendon se e njeh arabishten të përkthejë në gjuhën e tij amtare të cilën nuk e kupton që nuk e njeh aq sa i duhet për të përkthyer. Më bie shpesh rasti të lexoj përkthime në gjuhën shqipe apo edhe të dëgjoj ligjërime që mbartin dukshëm strukturën e gjuhës arabe. Kjo lloj gjuhe e shartuar përveç shijes së keqe që të lë kur e dëgjon, bëhet shumë herë edhe e pakuptueshme, madje edhe për ata që e njohin arabishten. Sa e sa herë më është dashur për t'iu kthyer tekstit origjinal për të kuptuar se çka dashur të thotë autori, sepse përkthimi i çalë e i fjalë për fjalë ishte një rebus i vërtetë. Për të mos folur pastaj për mangësi në të kuptuarin e arabishtes, në përkthimin e gabuar të shprehjeve frazeologjike, të termave... etj. Një tmerr i vërtetë! Sa që me të drejtë një shkrimtar musliman, që merret edhe me redaktime të shumë prej këtyre përkthimeve, punën e tij në këtë drejtim e quante: çmontim i bombave me sahat.

Me të drejtë lind pyetja: Si mund tu përçohet shqiptarëve mesazhi i Islamit në këtë mënyrë?!

Një tjetër problem i ligjërimit islam është edhe njohja e dobët e gjuhës letrare shqipe. Keq apo mirë ne sot për sot kemi një gjuhë standarde e cila duhet respektuar, sidomos në shkrimin e saj. Por, më tepër problem sesa të ligjëruarit toskërisht apo gegërisht është ligjërimit i një gjuhe që nuk është as njëra dhe as tjetra, nuk është as arabisht e as turqisht dhe as anglisht e as italisht, por është një hibrid që në fund të fundit nuk është një shqipe e kuptueshme për të gjithë njerëzit.

Nëse do t'i kthehemi historisë së shqiptarëve nën kalifatin osman do të vëmë re se një nga arsyet pse shqiptarët në shumicë, sidomos pjesa e pashtolluar, nuk patën një qasje të thellë ndaj parimeve të besimit islam ishte edhe moskuptimi i gjuhës me të cilën atyre iu përçuan këto parime. Ky fenomen u has edhe me ortodoksët, por jo me katolikët. Kjo është edhe një nga arsyet e shumta pse këta të fundit që nga krijimi i shtetit shqiptar e deri më sot rezultojnë me humbjet më të pakta

në përqindje.

E folura bukur, pastër dhe qartë ka një rëndësi të madhe në ligjërimit islam, në përcimin e mesazhit të Zotit të njerëzve. Nëse kësaj i bashkohet edhe kultura e nevojshme besoj se do të bënim një hap të madh cilësor në thirrjen e njerëzve për tek Allahu.

Ajete dhe hadithe të shumta e shprehin këtë nevojë, dhe ja disa prej tyre:

*"Elif, Lâm, Râ. Këto janë vargjet e Librit të qartë! Ne e zbritëm këtë Kuran në gjuhën arabe, për ta kuptuar ju."*⁴

*"Kurse ky (Kurani) është në gjuhën e qartë arabe."*⁵

*"Nuk ka dyshim se ky (Kuran) është Shpallja e Zotit të botëve... E zbriti në gjuhën e qartë arabe."*⁶

*"Ne e kemi shpallur Kurandin në gjuhën arabe dhe pa asnjë kundërthënie, me qëllim që ata ta ruajnë veten nga e keqja."*⁷

Në këto ajete dhe të tjera Allahu u kujton arabëve këtë mirësi të Tij që Ai librin e Tij ua shpalli në gjuhën që ata kuptojnë dhe jo vetëm kaq, por në një gjuhë të kthjellët dhe të qartë, vetëm e vetëm që mesazhi i Zotit të përçohet tek ata në mënyrë sa më të kuptueshme.⁸

Elokuenca e mrekullueshme dhe e papërsëritshme e Kuranit nuk kishte si qëllim të saj vetëm të tregonte burimin se nga ai erdhi, por edhe për të qenë plotësisht i kuptueshëm dhe tërheqës për njerëzit, ku bashkë me ëmbëlsinë e gjuhës ata do të shijonin dhe ndjenin edhe thellësinë kuptimore të përmbajtjes së tij, kjo madje është më e rëndësishme sesa e para, gjë për të cilën Allahu kishte shfaqur edhe prova të tjera se ky libër vinte prej Tij.

Një nga shokët e Profetit të bekuar, Abdullah ibn Mesudi, dhe një nga njohësit më të mirë të Kuranit thoshte: "Lexojeni Kur'anin dhe tronditni me të zemrat."⁹ Vetë i Dërguari i Allahut falë mirësisë së Zotit zotëronte një të folur me qartësi mbresëlënëse, sa që është kjo një nga arsyet pse ndjekësit e tij ishin në gjendje të memorizonin dhe të përcillnin për te brezat që do të vinin edhe shumë kohë më pas fjalët e tij. Profeti i Zotit thoshte: *"Më janë dhuruar fjalët përmbledhëse"*¹⁰ çka do të thotë se ai me pak fjalë, qartë dhe shkoqur, u përcillte njerëzve mesazhe të mëdha. Për efektin që të folurit e bukur dhe i qartë ka te njerëzit i Dërguari i Zotit shprehej: *"Ka prej gojëtarisë që të magjeps."*¹¹ Vetë fjala arabe *bejan* e përdorur në këtë rast tregon për qartësinë dhe të folurin bukur.

Aftësia për të folur bukur dhe qartë është e dhuruar dhe e fituar. Për sa i përket të parës kemi pak për të thënë, pasi ajo është një mirësi e Zotit që ia jep

4. Jusuf: 1, 2.

5. En-Nahl: 103.

6. Esh-shuara: 191-195.

7. Ez-zumer: 28.

8. Shih komentin e Tabariut e të tjerë, për këto ajete.

9. Es-sunen el-kubra, El-bejhaki 3/13.

10. Buhariu dhe Muslimi, për një koment më të zgjeruar të këtij hadith shih komentet e dyzet haditheve nga Ibn Rexhebi.

11. Buhari etj.

kujt të dojë. Por këtu duhet të tërheqim vëmendjen për një fakt mjaft të rëndësishëm që publicisti Agim Baçi me të drejtë e ka vënë në dukje në esenë e tij të shkurtër "Teoria e komunikimit në Islam". Ai vë në dukje rëndësinë që ka komunikimi dhe se si jo gjithmonë aftësia për të komunikuar i jepet më të diturit, ndërkohë që një i ditur tjetër, që e ka më të zhvilluar këtë aftësi, ka më tepër përparësi në përcjelljen e mesazhit të Zotit dhe për këtë ai gjen një shembull mjaft të goditur, atë të Musait me Harunin. Sesi i pari ishte më i ditur, por i dyti ishte më gojjetar, ndaj dhe Musai i jep të vëllait përparësi karshi vetes në komunikimin e fjalës së Allahut.

Nëse gojëtaria e dhuruar është një mirësi që ne nuk e kemi në dorë, ajo e fituar është plotësisht e mundshme. Dhe kjo gojëtaria e domosdoshme për thirrjen islame arrihet duke njohur mjaftueshëm gjuhën shqipe, kulturën dhe traditën e të folurës dhe të shkruarit të këtij populli, temperamentin e tyre dhe realitetin me të cilin njerëzit jetojnë. Me këtë nuk dua të them se është e domosdoshme që një predikues apo hoxhë duhet patjetër të mbarojë fakultetin e gjuhë-letërsisë shqipe, çka në vetvete do të ishte vërtetë diçka e dobishme, por një njeri që ka marrë rolin e komunikuesit të Islamit te njerëzit duhet patjetër të thellojë njohuritë e tij karshi gjuhës, folklorit dhe letërsisë shqipe, së paku nëpërmjet leximit të vazhdueshëm të kësaj literature. Ky vetëtrajnim nuk duhet të ndërpritet për aq kohë, së paku, sa të thyhet arabizimi i gjuhës shqipe nga ana e hoxhallarëve dhe të ndjehet te njerëzit se predikuesit flasin tamam shqip, në formë dhe përmbajtje.

Shumë ajete dhe hadithe janë shndërruar në fjalë të urta për arabët, pikërisht sepse ato mbartin mrekullisht nivelin më të lartë të kësaj gjuhe. Ndaj dhe vënia në përdorim e fjalëve të urta të popullit, krahasimet, dhe shembujt e nxjerra nga kultura e këtij populli bën që njerëzve t'u ngjallet më tepër interes për predikimet fetare dhe njëkohësisht të përthithen më lehtë nga ta.

Siç edhe vihet re gjatë kësaj trajtëse gradualisht jemi futur në anën e dytë që përmban kuptimi i ajetit "**Ne nuk kemi çuar asnjë të dërguar, përveçse në gjuhën e popullit të tij, për t'u shpjeguar atyre (shpalljet e Zotit)...**", në përmbajtjen e ligjërimit fetar.

Disa nga mangësitë që vihen re në këtë drejtim janë:

1) Trajtimi në formë akademike i fesë, si në hutbe ashtu edhe në mësimet që jepen nëpër xhami.

Është e natyrshme që kjo ka ardhur si reflektim i mënyrës sesi ne e kemi mësuar fenë në auditorët e universiteteve islame, në mësimet dhe ligjëratat e marra nga dijetarët dhe predikuesit e ndryshëm që ligjëronin nëpër xhamitë e vendeve ku kemi studiuar.

Kurani është një libër dije, por dija e tij nuk trajtohet në të në formë akademike, ajo trajtohet në formën e një këshille të gjallë duke u bërë pjesë e realitetit. Vetë Allahu e ka quajtur Librin e Tij këshillë: "**O njerëz, ju ka ardhur këshillë (Kurani) nga Zoti juaj, shërim për zemrat tuaja, udhëzim dhe mëshirë për besimtarët.**"¹²

Vetë forma e artikullimit dhe e ligjërimit të çështjeve të trajtuara në Kur'an, është dëshmia më e mirë për t'iu larguar akademizmit në përcjelljen e fesë te njerëzit.

2) Mbingarkesa e ligjërimit islam me rregullat e jurisprudencë islame, me haramin dhe hallallin... etj.

Edhe në këtë rast na vjen në ndihmë stili i Kuranit. Në ajetet dhe suret që kanë zbritur në Mekë lehtësisht dallohet një përqendrim në parimet bazë të besimit, në njësimin e Zotit dhe besimin në botën tjetër, ku ajetet e suret janë edhe më të shkurta dhe në përgjithësi ligjërimit islam në këtë periudhë të shpalljes ishte më i shkurtër. Ndërsa në ajetet dhe suret që kanë zbritur në Medine shohim një gjatësi dhe një shtjellim më të gjatë, dhe sidomos në ajetet që flasin për normat ligjore, për hallallin dhe haramin. Por sidoqoftë, në të gjithë Kurandin që përmban mbi gjashtëmijë e dyqind ajete, vetëm rreth pesëqind ajete trajtojnë çështje të normave dhe ligjeve islame, ndërsa pjesa tjetër merret me besimin te Zoti, botën tjetër, historitë e popujve të mëparshëm etj. A nuk është ky një argument i rëndësishëm se njerëzve u duhet folur më shumë për Zotin, për premtimet dhe mirësitë e Tij, sesa për urdhërsat dhe ndalesat? A nuk thotë nëna e besimtarëve Aishja se: "*në fillim zbritën suret e shkurtra në të cilat përmendej Xheneti dhe Zjarri deri sa kur njerëzit iu kthyen me shumicë Islamit, zbriti hallalli dhe harami. Nëse do të kishte zbritur që në fillim: mos e pini alkoolin, do të kishin thënë: nuk do ta lëmë alkoolin asnjëherë, dhe nëse do të kishte zbritur: mos bëni kurvëri, do të kishin thënë: nuk kemi për ta lënë kurvërinë asnjëherë.*"¹³!

3) Mungesa e theksuar e trajtesave që merren me edukimin shpirtëror dhe moral të besimtarëve.

Islami nuk është një fe që i jep rëndësi vetëm anës së jashtme, vetëm formës dhe jo përmbajtjes. Në Islam edhe forma edhe përmbajtja janë të pandara dhe të rëndësishme, por duhet theksuar se përmbajtja ka më tepër rëndësi. Sa herë kemi vënë re që falja që ne kryejmë nuk na jep ndjesinë e rehatisë shpirtërore? Sa prej nesh falin me dëshirë edhe namaze fakultative, përveç atyre të detyruara? A nuk ishte Profeti i Zotit që thoshte: "*Dhe kënaqësinë unë e gjej te falja.*"¹⁴! Sa prej nesh dhe njerëzve që ne u predikojmë e ndjejnë afërsinë e Allahut në jetën e tyre të përditshme? Sa prej nesh e përjetojnë se jetojnë me Zotin në çdo hap që hedhin, në çdo fjalë që thonë, në çdo veprim që bëjnë? Sa prej nesh e kanë ndjerë fjalën e Profetit (paqja e Zotit qoftë mbi të), kur ai përgjigjej Xhibrilin për shtyllën e tretë të fesë: "*Mirësia, është ta adhurosh Allahun sikur ti sheh Atë, por nëse ti nuk e sheh Atë, (ti ndjen se) Ai të sheh ty.*"¹⁵

Po morali, edukata dhe etika islame në ç'nivel janë në radhët e besimtarëve? Sa e sa ajete dhe hadithe kanë ardhur në këtë drejtim? A nuk thotë Profeti se: "*Me të vërtetë besimtari me moralin e tij të mirë arrin gradën e atij që falet dhe agjëron.*"¹⁶

A nuk është edukata dhe normat e mirësjelljes, me të gjithë njerëzit, pjesë e moralit islam? A nuk është mbajtja e

premtimit, korrektesa, shlyerja e borxhit dhe burrnja pjesë të këtij morali? Nëse ne si besimtarë kemi mangësi në këtë drejtim, a nuk vjen kjo edhe sepse për të tilla tema pak është ligjëruar dhe shumë më pak zbatohen?! A nuk u është kërkuar besimtarëve që të kapen pas sunnetit të Profetit (paqja e Zotit qoftë mbi të), ndërkohë që sunneti reduktohej vetëm në disa veprime dhe shfaqje të jashtme, ndërkohë neglizhohej edukata dhe morali, a thua vallë se kjo nuk i përkiste sunnetit?!

4) Trajtimi i kufizuar i njësimin të Zotit brenda një hapësire të ngushtë shembujsh. Njësimi i Zotit në Islam është boshti kryesor rreth të cilit vërtitet e gjithë feja, por ky njësim dhe e kundërta e tij, shirku, nuk kufizohen vetëm në shembujt klasikë, që janë dukshëm të qartë. Idhujtaria shfaqet edhe në ideologjinë dhe mendësitë e njerëzve edhe nëse ata i besojnë vetëm një Zoti dhe nuk u luten të vdekurve. A nuk është materializmi, dashuria e tepruar për të mirat e kësaj bote një lloj shirku që i largon njerëzit nga adhurimi i Zotit në adhurimin e parasë? A nuk janë pasionet e shfrenuara për artet, teknologjinë dhe argëtimin një lloj shirku që zënë vend në zemrat e njerëzve shumë më tepër sesa Zoti duhet të zërë në to?! Ky lloj shirku sot është bërë shumë më i përhapur sesa dikur dhe zbrazëti që krijohet në zemër nga mungesa e Zotit u lë vendin me shumicë gjërave të tilla. Është pra e natyrshme që ligjërimit islam i sotshëm për teuhidin dhe shirkun të përfshijë edhe dimensionet të tilla.

5) Të mos qenit realist me vendin dhe situatën ku jetojmë, në ligjërimin e temave që zgjidhen për tu trajtuar apo edhe mënyra sesi trajtohen.

Jetojmë në një ambient tjetër nga ai në të cilën shumë prej nesh janë shkolluar, në një ambient ku njerëzit ndër-gjegjësimin fetar e kanë shumë të ulët, ndaj edhe jo për çdo gjë për të cilën muslimanët e vendeve islame janë të ndërgjegjshëm se Allahu i urdhëron apo i ndalon vlejën edhe në mesin e shqiptarëve. Kjo nuk do të thotë aspak që atë për të cilën ne besojmë se është haram t'ua bëjmë njerëzve hallall apo ajo çka është obligim tua bëjmë atyre fakultative. Por, sidoqoftë njerëzve u duhet folur së pari dhe më së shumti për gjëra që i njohin dhe pranojnë se janë të mira dhe të këqija. Vetë fjala në arabisht që përdoret për urdhërimin në të mirat është fjala *maruf* çka në vetvete ka kuptimin e diçkaje të njohur, të ditur dhe të pranuar. Nga e njëjta rrënjë rrjedh edhe fjala *urf* që do të thotë traditë, zakon. Po kështu edhe fjala që përdoret për ndalimin nga e keqja është fjala *munker* çka do të thotë diçka e panjohur, e shëmtuar, e pazakonshme. Pra e thënë ndryshe maksima islame "të urdhërosh për të mira dhe ndalosh nga e keqja" është e lidhur edhe me realitetin se çfarë njerëzit dhe traditat e tyre quajnë të mirë apo të keqe. Duke mos lënë pa theksuar këtu se jo çdo gjë që njerëzit e një vendi apo tradite e quajnë të mirë apo të keqe edhe nga feja konsiderohet si e tillë. Me këtë fakt më tepër, të zbrëthimit gjuhësor të këtij parimi islam, dua të tërheq vëmendjen për rëndësinë që ka në ligjërimin islam njohja e zakoneve dhe traditave me të cilat njerëzit jetojnë. Këtë që thash e

mbështes edhe në një thënie mjaft të njohur të sahabit të nderuar Ali ibn Talibit, që thotë: "Flitini njerëzve me atë çka njohin, a dëshironi që të përgënjeshtrohet Allahu dhe i Dërguari i Tij?!"¹⁷ A nuk vinë këto fjalë të këtij sahabi të madh si një thirrje për ne sot, që ligjërimin islam ta kemi më pranë problemeve, halleve të njerëzve dhe të kuptuarit të tyre?!

Ligjërimit islam krahas pikësnyimeve të tij madhore që kanë të bëjnë me besimin te Zoti, duhet të drejtohet edhe nga problemet dhe shqetësimet që ka një shoqëri e caktuar. Kështu, nëse i kthehemi Kur'anit do të shohim sesi Profetët e ndryshëm të Zotit krahas thirrjes për njësimin e Zotit, i këshillonin njerëzit edhe për problemet specifike që ata popuj kishin, si për shembull në rastin e Shuaibit, ku krahas teuhidit ai u predikoi edhe ndreqjen e marrëdhënieve financiare. Ndërsa interesant është fakti se për Profetin Lut nuk shtjellohet në Kuran predikimi i tij rreth teuhidit, siç shtjellohet për Profetët e tjerë, jo se ai nuk e ka bërë një gjë të tillë, as që mund ta mendojmë, por ama vetë Allahu në Kuran na ka përmendur vetëm predikimin e tij për ndreqjen e anës morale të atij populli.¹⁸ Kjo mesa duket për vetë ekstremitetin negativ që paraqiste gjendja e tyre morale. Dhe ky fakt na lë të kuptojmë se në situata të caktuara ligjërimit islam mund të drejtohet kah problemeve më të mprehta që shqetësojnë shoqërinë, çka do të thotë se besimi te Zoti dhe teuhidi në këtë rast u jepën njerëzve në mënyrë të tërthortë dhe jo të drejtpërdrejtë, siç bëhet në shumicën e rasteve.

Thirrja islame në një shoqëri apo grupim të caktuar duhet të përmbaj, brenda mundësive, shembuj të kapshëm dhe sa më të afërt për këtë shoqëri e sa më pak ngjarje dhe krahasime me vende dhe njerëz të largët në kohë dhe hapësirë, për këtë shoqëri. A nuk e shikon sesi Allahu dhe i Dërguari i Tij përdorin mjaft shembuj nga jeta e përditshme e arabëve, krahas atyre historik, që mesazhi i Zotit të ishte sa më i kuptueshëm për këta njerëz.

Dhe së fundi duke mbyllur trajtesën time, por jo temën e cila gjithsesi ngelet e hapur për zhvillim të mëtejshëm do t'ua bëja thirrje të gjithë thirrësve islam që t'i lënë kompleksitet që kanë ndaj njeri-tjetrit dhe të bashkërendojnë energjitë e tyre për tu dhënë zgjidhje kolektive këtyre problemeve dhe të tjerave, pasi kjo është shumë më e rëndësishme për ecurinë afatgjatë të thirrjes islame sesa strategjitë dritëshkurtra në marrëdhëniet me disa mediokër klanor që mbarsin vetëm shterpësi.

"Vërtet, këtu ka këshillë për këdo që ka zemër, dëgjon me vëmendje dhe dëshmon."¹⁹

Allahu e di më së miri.

17. Transmeton Buhari.

18. Shih sure Esh-shuara: 160-173 dhe En-neml: 3-57.

19. Kaf: 37.

12. Junus: 57.

13. Transmeton Buhari.

14. Transmeton Ahmedi, Nesai etj.

15. Transmeton Buhari dhe Muslimi.

16. Transmeton Ahmedi, Ebu Daudi, Ibn Hibban.

TË ALLAHUT JEMI DHE TEK AI DO TË KTHEHEMI

Këto janë fjalët e shkëputura nga fletët e ditarit që ka mbajtur një motër muslimane, pasi djali i saj pësoi një aksident i cili bëri që ai të ndërrojë jetë në Itali, ku punonte si emigrant. Quhej Idriz (Elvis) Ruzhdi Tymi, një besimtar musliman të cilin, ata që e njohën dhe ata që jetuan pranë tij, do ta kujtojnë gjithmonë si një njeri me zemër të madhe dhe shumë i dashur, tipare këto që u bënë edhe më të theksuara kur ai u bë pjesë e vëllezërve muslimanë që po punonin për të perhap mesazhin islam në Shqipëri dhe në hapësira të tjera, ku ai ishte, me të vërtetë, një thirrës islam. Kishte lindur në Shkodër në vitin 1978 dhe ishte 20 vjeç, kur u nda nga familja dhe nga vëllezërit e tij muslimanë, për t'u takuar me ta ishalla në xhenet. Në maj të vitit 1995, ai nisët në Itali tek i vëllai, pasi ka marrë në bagazhet e tij një sasi jo të vogël librash fetarë, ku janë edhe shumë kopje Kur'ani, duke na kujtuar se Idrizi ishte pjesë e rëndësishme e atyre të rinjve që po punonin me përkushtim që feja islame, për muslimanët shqiptarë, të ishte pjesa më e rëndësishme e jetës së tyre. Jeta e re në një vend të huaj do ta bënte këtë vëlla musliman që edhe në këtë hapësirë të panjohur të jetonte si musliman dhe ta vazhdonte detyrën e tij që i pat ngarkuar Allahu xh.sh. si thirrës në islam. Megjithatë xhamia më e afërt ishte 70 kilometra larg, ai do të ishte pjesë e xhematit ditën e xhuma dhe më pas do të merrte një dhomë me qira me paratë e veta, ku shumë të rinj muslimanë do të falnin vaktet e namazit. Dhe të mos harrojmë se paguantë 250 mijë lireta për këtë xhami që nuk kishte minare, por kjo nuk ishte pengesë që aty të ndigjohet fjala e Allahut. Vëllezërit muslimanë, që kanë qënë pranë tij, e mbajnë



NË TË MAJTË ELVIS (IDRIZ) TYMI

mend se, deri pas mesnate, ai falej në xhami dhe se shqetësimi i tij mbetej gjithmonë shtimi i umetit musliman me besimtarë të rinj. Në shenimet e tij, që janë hedhur në një fletore të thjeshtë, ai shkruan se e kam detyrë që edhe familjen time ta afrojmë sa më pranë fesë islame, në një kohë që shumë të rinj italianë i ishin këthyer fesë islame, falë punës dhe angazhimit të Idrizit për të hapë Mesazhin Islam. Ky vëlla musliman nuk po punonte për të shijuar dynjallekun, por ai punonte dhe mendonte gjithmonë për Ahiretin. Prandaj, dita e Bajramit atë e gjen-te në xhami duke falur Bajramin dhe duke dhuruar rrogën e tij, që kishte para hallalli, për nevojtarët. Ishte data 31 janar e vitit 1998, kur muslimanët po festonin Bajramin, ditë që për Idrizin ishte dita më e bukur e vitit, sepse muslimanët festonin festën më të bukur për ata. Po shkonte me mo-

torr për të bërë bajram me vëllezërit e tij muslimanë dhe po ecte shpejt që t'i përqafonte të gjithë në këtë ditë të madhnueshme. Por, motorri rrëshqiti dhe vllau musliman u nda nga familja dhe nga të gjithë vëllezërit e tij muslimanë për të mbetur gjithmonë pranë tyre me veprën dhe punët e mira që ai kishte bërë në dobi të çështjes islame. Dhimja ishte e madhe dhe thuajse e papërbalueshme, sidomos për familjen dhe në veçanti për nanën e tij, Nafijen. Në një ditar të thjeshtë, por të mbushur me shumë durim, kjo motër muslimane ka shkruar se si e ka përjetuar këtë dhimje që vetëm një zemër nane mund ta përjetojë. Për nanë Nafijen, kjo ishte një sprovë që Allahu ua kishte dërguar për të pare sa ishin të gatshëm ta pranonin rriskun që u kishte caktuar Ai dhe se ishte Allahu që ua kishte bërë këtë dhuratë përko-hësisht dhe përsëri Ai e kishte marrë

për vehte. Megjithatë dhimja ishte e madhe, Allahu ua kishte forcuar zemrat familjes dhe vëllezërve të tij muslimanë për ta përballuar këtë sprovë. Në ditarin e nanës së Idrizit, ne lexojmë se ajo e kishte kuptuar që Allahu i kishte dhuruar Idrizit dhuratën më të çmuar për një musliman e cila ishte besimi tek Madhështia e Allahut xh.sh. i cili ia ndriti jetën të birit të saj me këtë besim, për të cilin ai punoi aq shumë. Për të birin, nana ka shumë mall. Për vëllaun musliman, të gjithë vëllezërit e tij kanë shumë mall. Prandaj, po i shkruajmë këto rreshta që ta kujtojnë në këtë 10 vjetor duke besuar që ky vëlla musliman ishalla po pushon në xhenet dhe ishalla familja e tij dhe vëllezërit e tij do të jenë banorë të xhenetit dhe do të takohen aty më Idrizin e tyre të dashur. E kemi lënë për ta vendosur në fund të këtij shkrimi një argument që e plotëson figurën e këtij besimtar musliman. Vëllezërit muslimanë që u falen në xhami pranë tij dhe ata që paten ndigjuar bisedat e tij, kujtojnë dëshirën që kishte gjithmonë Idrizi për të plotësuar një nga shtyllat e Islamit, Haxhin, por që jeta e tij e shkurtër nuk ia mundësoi. Në vitin 2006, një vëlla musliman arab, që ishte falur me Idrizin në xhami e bëri haxhin në Mekë për Idrizin duke ia plotësuar edhe më shumë portretin e tij si besimtar musliman. Allahu ishalla i shton rrallët e umetit musliman me besimtarë të devotshën si ishte Idrizi, që Feja Islame të jetë një hapësirë ku njëzërimi të gjejë shpëtimin e vet dhe lumturinë e vet.

Përgatiti Selim Gokaj

Duke u mbështetur tek të dhënat e familjes së Idriz Ruzhdi Tymi

NDËRROI JETË AKTIVISTI MUSLIMAN HIVZI BRAHIM KOTRRI



Me datën 17 maj 2008, në një aksident rrugor, ndërroi jetë Hivzi Brahim Kotrri, një aktivist i njohur i shoqatës Bamirëse Islame Shkodër i njohur gjithashtu edhe si financier i kësaj shoqate. Për të gjithë ata që e paten njohur Hivzinë dhe që, për hir të së vërtetës nuk ishin pak, do të mbahet mend si një njeri aktiv dhe i gatshëm të ndante hidhërimet dhe gëzimet me shokët dhe me miqtë e tij. Ky vëlla musliman ishte pjesë e trungut familjar të një famijeje të vjetër shkodrane e njohur sidomos për ushtrimin e profesionit të sahatçisë, profesion që i afroi pjesëtarët e kësaj familjeje më shumë me një rreth të gjërë shoqëror. Nga ana tjetër, brezat e kësaj familjeje kanë qënë gjithmonë pranë fesë islame të cilën e kanë pasë pjesë të jetës së tyre, sepse e kanë praktikuar fenë islamë dhe e kanë respektuar atë në ambjentet ku ata kanë punuar dhe jetuar. I njohur si sahatçi i

nderuar dhe besimtar që ka falë 5 vaktet ka qënë edhe i jati i Hivzisë, Brahim Kotrri.

Hivzi Kotrri ka qënë një familjar i rregull dhe familja për këtë vëlla musliman ka qënë preokupimi kryesor i tij, kërkesë kjo që është shtruar gjithmonë nga feja islame për çdo besimtar musliman. Brezi që jetoi dhe u rrit me Hivzi Kotrri e mban mend edhe për aktivizimin e tij në sportin e atletikës, ku u njoh si një atlet i cili pat arritë rezultate të larta. Kujtojmë se disa ditë pas aksidentit tragjik, në një emision të kanalit televiziv lokal, Shkodra Tv 1 Chenell u kujtua atleti i traditës së qytetit të Shkodrës Hivzi, Kotrri. Me ardhjen e demokracisë, Hivzi Kotrri ishte pjesë e asaj shtrese të popullsisë që e ndeju gëzimin e rrëzimit të diktaturës komuniste, e cila kishte qënë edhe për këtë vëlla musliman një rreth i hekurt në qafë që ia pat bërë jetën të padurueshme.

Por, në këto vite atë e goditi një fatkeqësi e rëndë familjare, sepse i vdiq gruaja duke e vënë para përgjegjesive edhe më të rënda familjare. Janë bërë shumë vite kur ai ishte anëtar i këshillit drejues të shoqatës Bamirëse Islame ku u dallua si një aktivist i shquar i kësaj shoqate. Në të gjithë aktivitetet dhe në të gjithë përvjetorët e kësaj shoqate, ai ishte ndër të parët që angazhohej që punët të shkonin sa më mire. Humbja e këtij vëllau musliman është një humbje për të gjithë shoqatën Bamirëse Islame dhe për të gjithë familjen, për shokët që i patë njohur Hivzi Kotrri i cili do të mbahet mend prej tyre si një familjar i mire, si një aktivist i dalluar islam dhe si një mik i paharruar.

Haxhi Vehbi Dani

Kryetar i Shoqatës Bamirëse Shkodër

Studentet muslimane të Universiteteve të Turqisë do të mbajnë shami

Parlamenti ne Turqi, falë një aleance në mes magjorancës dhe një pjese të opozitës ,ka arritur që të aprovojë një rezolutë, që mund të ketë marrë edhe mandatin e një ligji, që studentet universitare në Turqi do të lejohen që të vazhdojnë studimet e larta ,duke gëzuar të drejtën e mbajtjes edhe të një shamiae muslimane nga ato që kanë vendosur të jenë të mbuluara, konformë urdhërit të Allahut xh.sh. që e obligon femrën muslimane të mbajë shami . Kjo arritje është një sukses për pozitën e femrës në shoqërinë e sotme turke e cila po e zgjeron demokracinë në të gjitha sferat e jetës së saj , aq më tepër në sferën e religjonit ,ku populli turk është aq i ndjeshëm. E drejta për të vazhduar një studente turke shkollën e lartë, kur ajo ishte e mbuluar me shami, ishte nëpërkëmbur keqas nga fryma laike që kishte marrë pamjen e një merimange që po ua merrte frymën studenteve muslimane në Turqi, duke i detyruar që ato të humbisnin të drejtën e arsimimit të lartë dhe t'u kufizohej mundësia për dhënë maksimumin e tyre intelektual në shërbim të shoqërisë dhe të personelit të tyre. Por, duhet që të lakohet edhe një paradoks që e shoqëroi me vite të tëra këtë arritje të shoqërisë së sotme turke e cila ka të bëjë me parametrat që Bashkimi Evropian po i kërkon Turqisë që ajo të jetë pjesë e BE.Ajo që të bie në sy është larmia e këtyre kërkesave të fshehura pas sloganit "Mbrojtja e të drejtave të njeriut" e cila ,sipas politikanëve evropianë ,në shtetin turk nuk

po realizohet..E vërteta e këtyre kërkesave synon që t'ia ngushtojë qëllimisht hapësirën e hyrjes së Turqisë në BE,sepse vetë opinjoni publik në vende të tilla si;Franca .Hollanda, Austria janë një bllok e madh që po e kundërshtojnë anëtarësimin e këtij vendi në BE. Por, asnjëherë politika evropiane nuk u kujtua që të dënojë shtetin laik turk që po shkelte të drejtat e vajzave me shami muslimane, të cilat po mbeteshin jashtë dyerve të universiteteve dhe po detyroheshin të shkolloheshin jashtë Turqisë ,ose të mbeteshin pa arsim të lartë.Me këtë qëndrim, BE po përdorte standarte të dyfishta për të inkurajuar zbatimin e të drejtave të njeriut në Turqi, veprime këto që janë pjesë e strategjisë së saj që daton nga koha e kryqzatave, për të siluruar interesat e muslimanëve në hapësirat ku ato jetojnë,duke u kujdesur gjithmonë që popujt muslimanë të penalizohen dhe të jenë sa më larg zhvillimit dhe përparimit. Muslimanët, kudo që janë, pa tjetër e përshëndesin këtë arritje të të rendësishme të politikës turke e cila ,me një kryeministër të sukseshëm si :z.Taip Rexhep Erdogan dhe me një presiden imponant si; z.Abdullah Gyl, tregoi se sot qeveria turke po bëhet zëdhënëse e vërtetë e interesave dhe aspiratave të popullit që, në mënyrë masive ,e votoi magjorancën që po drejton sot drejt arritjeve Turqinë ,arritje tashmë që janë lehtësisht të lexueshme për opinjonin publik.

Selim Gokaj

KRYEPARLAMENTARJA TOPALLI NE NJE VIZITE NE ARABINE SAUDITE

Në kuadër të lëvizjeve të politikës shqiptare për të rritur numurin e vendeve që do të njohin Pavarësinë e Kosovës, z. Topalli bëri një vizitë në Arabinë Saudite në përpjekje që edhe ky shtet të rrallitet në circuitin e atyre shteteve që do të njohin Pavarësinë e Kosovës.Ishte një pritje shumë miqësore për diplomatën shqiptare nga mbreti saudit që është larg qëndrimeve mediatike e cila në Shqipëri penalizon çdo gjë arabe duke mbajtur një heshtje varri për jetën politike , kulturore dhe ekonomike që zhvillohet në këtë hapësirë jetike të planetit tone që ka dhënë njerëzimit vlera të gjithanëshme dhe vazhdon t,i jape edhe sot vlerat dhe arritjet e saj . Vetëm diçka nuk harrojnë të kujtojnë pa ndërprerje mediat shqiptare . Të japin lajmë "të peshkuara " në media të huaja, vendet e të cilave kanë llogari për të bërë me botën arabe, sepse ato përplasen për probleme ku po angazhohemi edhe ne pa të drejtë . Megjithatë bota arabe dhe veçanarisht Arabia Saudite e pritën mire politikanen shqiptare e cila, pasi po dublon ministrin e jashtëm Basha, duket se do të mbesë në historinë e diplo-

macisë shqiptare një ambasadore që ka shetituar më shumë vendet muslimane , vizitë që besojmë se do të jetë një shans i mire që politika shqiptare ta shikojë botën arabe si partnere ,jo vetëm kur ka nevojë, por të jetë partnere e botës arabe duke mos bërë lëvizje që nuk e njohin vijën e drejtë..Mendojmë se z. Topalli u tregua e kujdeshme edhe në paraqitjen e saj të jashtme gjatë vizitës tek mbreti saudit ,sepse ajo kishte respektuar traditën islame duke u prezantuar gjatë vizitës në oborrin mbretëror saudit e mbuluar me shall si mbulohe femrat muslimane. Politika shqiptare po investon shumë diplomatikisht në vendet muslimane. Të shohim a do të investojë edhe politikisht për të rregulluar imazhin e saj në sytë e muslimanëve të hapësirës arabe, për t,i bindur ata se edhe në vendet muslimane ka miq të sinqertë që duan të mbështesin çështje shqiptare, sepse për ata vende është fjala për të mbështetur një vend me popullsi dominante muslimane të cilët arabët fetarisht i kanë vëllezër.

H. Vehbi Dani

ORTAKET E DJALLIT

Pena e intrigës
Me frymën e urrejtjes kalemxhijt shfryjn
Në helmin e mashtrimit penën e ngjyejnë
N'vend që ajo penë njerëzimit t'i shërbejë
Me dorën e intrigës n'zjarr e kthejn.
N' zemrën e tyre ata kanë lavd ferri
T' ndezun me mjeshtri nga vet Luçiferri.
Por n' zjarrin që ndezin vet do t' bien
Cënimin e Islamits'do t'ia arrijn.
Ata janë pjellë e komunizmit
Dora e zezë e shovinizmit.
Emrat e tyre s' vlen të përmenden
S' bashku me djallin tërheqin parmendën.
Farën e intrigues mundohen ta mjellin
Por shosha e tyre s'e mbulojnë diellin.
Diellin Islam që Allahu dhuroi
Me dritën e tij gjithësinë ta ndrigojë.
Ata që se dijnë le ta mësojnë
Premtimet e Allahut n' vend do t' shkojnë.
Përsosjen e jetës Islami synon
Madhështia e tij kudo mbretëron.

Civilizimi Islam në t' gjitha fushat e tij
Njeriu është gjithmonë synimi i tij.
Matrapazavë t' intrigës qartë ua bajmë
Sado që t' paguhen shtrenj edhe majm.
Të plamë, t' pistë ,si ha as derri
Veshtrë i ka t,i përpijë edhe ferri.
Lexuesi i ndershëm dhe i denj
Në shkrimet e tyre helm do t' gjej.
Kalemxhij të tillë janë dallaveraxhij
Në shpirt dhe n' punë janë batakçi.
Shkrimet e tyre kurr s'do t' pin ujë
Për njerëz t'ndershëm ata janë t' huej.
Vllazën e motra mos u mashtroni
T'na përçajnë horat, kurr mos lejoni.
Vitët dhe shekujt qartë e bajnë
Intrigat e armiqve shqiptarët si ndajn.
Shovinistët grekë mire le ta dine
Ajo që pësoi shjkjau, atyre do t'u vijë.

Burhan Fili Miçigan USA

THIRRJE E HAPUR PER GENOCID KUNDER MUSLIMANEVE NE SHQIPERI

Me botimin ne gazetën Shekulli me datën 3 nëntor 2006 të artikullit, Një mjekër nje shami, me autor Skender Shkupin, historia kunder muslimaneve ne Shqiperi kapi majat me te larta. Nga Amerika e larget, qe per ne shqiptaret eshte vendi ku demokracia eshte ne piadestalin me te larte, ne media u hodhen ide te rrezikshme te cilat per here te pare i akuzojne, me nje potencial te rrezikshem, muslimanet shqiptare si rrezik I dites per Evropën e krishtere, sepse pikerisht ne Shqiperi po pergaditen repartee radikale islamike qe synojne te pergjakin kontinentin plak duke planifikuar, ne bashkepunim me qendra nderkombetare islamike, te vrasin me qindra mijra njerez, Duke pase si pike referimi problemin e nje vajze me shami dhe te nje djali me mjekër, te cilet rektori Agim Kukeli i penalizoi, jo nga pozita e nje administratori, por nga pozita e nje bahai aktiv, intelektual qe ka gjetur rehatine ne Amerike na shokon te gjithëve duke na kujtuar se ne shqiptaret qenkemi ne lufte dhe ne lufte lejohen masa drastike qe mund te shkelin te drejtat e njeriut. Pyetjes sone se kush eshte kundërshtari yne na jep shkrimi i kesaj medie, i cili, sipas tyre, eshte nje nazizem i ri me i rrezikshem se nazizmi I Hitlerit qe kerkon te vendose ne planet nje rend mizor. Ky nazizem i ri per ate qe e ka shkruar dhe per ato qe jane pas tij, eshte feja islame dhe besimetaret muslimane qe sot po perballen me nofken islamike, sikur keto te kishin prejardhjen nga nje majmun tjetër dhe jo nga ai per te cilin pohon Darvini prejardhjen e shoqerise njerezore. Dhe lulet e ketyre kamikazeve te ardhshem jane vajzat me shami dhe djemte me mjekra te cilet, me keto tregues ne veshjen e jashtme perçojne mesazhe terroriste ne ato ambjente ku ato levizin dhe jetojne, duke harruar se mjekra dhe shamia kane tregues se shkalles se perkushtimit ne fenë islame dhe nuk kane lidhje me tregues te terrorizmit dhe eshte pikerisht kjo rritje e perkushtimit ndaj fese islame qe i ben te zgjohen te trembur naten Kukelet, Shkupet dhe te gjithë skorten e tyre te rrezikshme. Edhe ne vende te terbuara kunder muslimaneve, ku militojne intelektuale me potencial te larte antimusliman, nuk eshte arritur te njehesohet shamia dhe mjekra e muslimaneve me kryqin e thyer te Hitlerit te cilet duket



se kete privilegj per ta hedhur ne media ia kane rezervuar nje shqiptari mercenar si Skender Shkupi qe duket se per thirrje masakrash kunder muslimaneve eshte peshe e rende per padronet e tij, sepse eshte e pamundur, qe nje person, pa nje prapavije meshtetese, te ndermarrë sulme te tilla kaq te rrezikshme, Duke shfrytezuar media qe ka ne pozicion te theksuar antiislam, Skender Shkupi me ne fund therret EURAKA, dukena dhënë rrugen per te shpetuar Shqiperine qe rrezikohet nga ato qe po pergadisin rendin e ri mizor per njerezimin duke na servirur si shpetim Turqine e Mustafa Qemalit i cili, sipas Shkupit burgosi dhe vraua mijra hoxhallare, masakroi turmat e mykura islamike duke e shpetuar Turqine nga portreti i nje Afganistani taleban, veprime keto qe shkelin te drejtat e njeriut, por aq te justifikuara per qellime te tilla madhore Duke arsyetuar ne kete linje, po per keto qellime madhore, ne Shqiperi duhet qe muslimanet te rruajne mjekrat dhe te heqin shamite vajzat nga koka dhe te pergaditen per te perballuar nje genocit te ashper alla Ataturk qe te kete sa me shume pastaj mjekra mafiozesh dhe vejza me bark jashte per te rrenuar moralin e shoqerise shqiptare qe pa tjetër do te pasoje shkaterrimin e te gjithë shoqerise shqiptare. Thirrje te tilla na kujtojne thirrjet e intelektualeve serbe, qe ne pragluftën e Bosnjes i kujtonin Evropës se krishtere se muslimanet e Bosnjes jane nje rrezik i tmerrshem per ate dhe te gjithë kemi ne kujtese ato qindra e mijra te vrare ne ate hapësire muslimane, ku pjesen e luanit ne ate masaker e paten ato qe e nxiten dhe e planifikuan ate masaker Ka shume mundesi qe muslimanet shqiptare te jene viktime e nje genocidi te

tille, sepse dy hapësira muslimane, Bosnja dhe Kosova jane masakruar duke ia lene duket rrallen tashme muslimaneve ne Shqiperin londineze. Kete ide po e kalojme ne media duke pase parasysh presionin ne rritje qe eshte shume i lexueshen ne hapësiren shqiptare qe daton me stuhine e kryqave, qe "lulezohen" nga Gjyrokastri ne Koman qe e kane kthyer Shqiperine ne nje kishe te stermadhe, sepse keto simbole te krishtera vendosen vetem ne kisha dhe ne varreza, duke vazhduar me presidentin qe i do shqiptaret te krishtere dhe me Mejdanin qe i do shqiptaret minorance dhe duke perfunduar me qarqet antiislame qe botojne karikaturat kunder profetit Muhamed ne Shqiperi per te afruar sa me prane naten e Shen Bartolomeut per muslimanet ne Shqiperi, duke synuar qe muslimanet ne kete hapësire ta shohin vehten te futur ne shishe si i vetmi vend i sigurte per ata E verteta eshte se ne Shqiperi muslimanet kane statusin e kulakut dhe te armikut te klases, status qe brezi yne fatkeq e perjetoi ne vitet e diktatures ortodokse-komuniste, sepse ato duket se po perjetojne ditet, kur do ta kene te veshitire te deklarojne fene e tyre islame. Nje mik i imi, intelektual i nderuar me tha nje dite se kam frike te vi ne nje mbledhje intelektualesh muslimane se m'i kane thene ne pune djalit se je djali i nje islamiku radikal Shenja te tilla ogurzeza per muslimanët, shqiptarë jane profeci të rrezikshme per te gjithë popullin shqiptar. sepse gjuhët e flakes se zjarrit, qe mund të piketohen piketohen mund të perpijne muslimane dhe te krishtere, hebrenj dhe bahaj si Kukeli dhe Kukele te tjere te cilëve po u shtohet numuri pa nderpreje ne Shqiperi Mendojme se

ketij sulmi frontal kunder muslimaneve ne Shqiperi i duhet thene ndal sa gjerat nuk kane precipituar ne kahun negativ, sepse muslimanet ne Shqiperi nuk jane te pergjumbur dhe nuk jane naïve dhe patjeter nuk e hane sapuin per dajthe. Ata e dine se ku fle lepuri dhe nuk do te jene kurre te gatshem t,ia vene koken ne kijotine ato qe per shembull perdorin Ataturkun e Turqise per te cilin flitet per nje lidhje te forte me rrethe hebreje te cileve ka mundesi tua kishte borxh rrenimin e kalifatit musliman per ndihmen qe i dhane keto qarqe per t,u afirmuar si "babai turqve" Eshte mire qe atyre, qe mendojne se ne kete klime politike dhe te fshehur pas luftes kunder terrorizmit, mund t'i mbyllin muslimanet shqiptarë ne nje geto ka mundësi t,u shpertheje mina ne duar dhe perpjekje te tilla mund të kthehen ne bumerang kunder tyre, sepse eshte vertetua se te sulmuarit pa te drejte ruajne patenciale marramendese per t,u shkaktuar disfata te paimagjineshme atyre qe i penalizojne dhe i cenojne pa te drejte. Populli shqiptar historikisht ka jetuar ne nje harmoni te admirueshme fetare me fetë e tjera ku muslimanet kane qene percaktues ne kete arritje madhore. Ka shume mundesi qe ato kancelari nderkombetare qe instaluan per dekada te tëra komunizmin ortodoks në Shqiperi, po bejne perpjekje per te instaluar nje komunizem te ri i cili tashme është shume i lexueshem nga secili shqiptar. Ky komunizem i ri eshte ATIISLAMIZMI.. Ngjarjet qe do te vijne pas, pa tjetër do te kete ngjarje, do te tregojne pozicionin e vertete qe do te ndermarrin muslimanet ne Shqiperi perballe ketij genocidi ne pergaditje kunder tyre dhe ato qe po e pergadisin kete genocit do te shokohen, kur te ballafaqohen me kete qendrim te muslimaneve ne Shqiper, te cilet nuki kane asnje detyrim askuj qe t'ua vene litarin ne gryke, sepse jetojne ne vendin e tyre dhe feje islame per ato eshte pjesa më e çmuar e jetes se tyre. Kush kërcënon jeten e dikujt pa te drejte duhet të llogarisë edhe reagimin e ashper të atij që është cënuar.

Selim Gokaj

Marrë nga arkivi i medjave të shkruara.

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ
BISMIL-LAHIRR-RAHMANIRR-RAHIME

Tregtojme
MISH HALLALL

E XHUMA PUSHIM → BESNIK ALUSHI ISMETI

Produkte Hallall

**KLIENTË TË NDERUAR!
VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,
MARKET "ISMETI" JU GARANTON**

**1- Produkte mishi hallall si:
sallam, suxhuk etj.
2- Piceri hallall
3- Fast Food hallall**

**Ju keni të drejtë të blini ku të doni
por hallalli i vërtetë është vetëm
tek market "ISMETI"**

Adresa: Pranë teatrit "MIGJENTI"
Cel: 0692101893

**EJANI TEK NE! FABRIKA E PERPUNIMIT
TE DRURIT**

ILIRIA

me pronar Haxhij Ilir Muja (aktivist dhe bami-rës Islam), ju afro-n prodhime nga me" të thjeshtat deri ne dhoma gjumi. Shërbehet ne kohe dhe me cilësi të larte:

Prodhim dyer e dritare

Dhoma gjumi

Pajisje zyrash

Pajisje kuzhine

Dhoma fëmijësh

Pajisje për ambiente lokalesh

Te gjitha këto me çmime konkurruese dhe me transport të garantuar falas. Ejani në fabrikën tone dhe do te mbeteni te kënaqur. Mund te kontaktoni me numrin e mobilit: 0692523565

